

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

PC STORE

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L01606034A

NUIS/NIPT

Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0672073033

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

042221076

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@pcstore.al

E-mail

Jurist Amarildo Arapi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/02/06

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0696954369

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-57534-01-31-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Shoqëria Rajonale Ujësjetillës Kanalizime Durrës Sh.A

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

5975666

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

“Shërbimi i printimit dhe fotopjimit”

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/02/15

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2023/02/15

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/80716/01312023

79521000-279810000-5

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

? Ligji 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (LPP)

? Ligjin Nr.9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, i ndryshuar (Ligji për Sistemin Buxhetor)

? VKM nr.285 datë 19.05.2021 “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK (RrPP)

? VKM Nr. 514 datë 20.9.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (lqp) (të rishikuar)

? Rekomandimi Nr.7998 të datës 24.12.2021 i Agjencisë së Prokurimit Publik

? Jurisprudencë: Vendimi i GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës”

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkonti pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Shoqëria PC STORE shpk është një shoqëri e themeluar e e organizuar sipas legjislacionit tregtar shqiptar dhe e ushtron aktivitetin në fushën e shitjes, ekspertizës, konsulencës, instalimit, konfigurimit të produkteve, shërbimeve, zgjidhjeve në fushën e IT, pajisjeve kompjuterike, pajisjeve të rrjetit, fotokopjimeve, sistemeve të rrjetit, serverave, Audio, UPS, etj.

Si një shoqëri tregtare PC STORE shpk e ushtron aktivitetin edhe në ofertimin tenderimin dhe lidhjen e kontratave publike sipas akteve normative në fushën e prokurimit publik në RSh. PC STORE shpk ka një eksperiencë 10 vjecare në fushën e kontratave publike, në furnizimin e institucioneve dhe enteve publike me mallra, shërbime dhe zgjidhje të ndryshme në fushën e IT/ICT.

Autoriteti Kontraktor (AK) Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sh.a me datë 31/01/2023, për nevojat e tij ka shpallur në portalin e prokurimit publik të APP, procedurën e prokurimit të llojit “Procedurë e hapur e thjeshtuar me nr : REF-57534-01-31-2023, me objekt “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit” me fond limit 75.975.666,67 (Pesë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.

Shoqëria PC STORE shpk është një shoqëri e interesuar për të ofertuar në këtë procedurë dhe po përgatit dokumentacionin teknik, ligjor, ekonomik dhe financiar konform kriterëve të tenderit. PC STORE pas këqyrjes me imtësi të kriterëve të tenderit të paraqitura në DT dhe të agrumentuara në procesverbalin e ngakruar në portalin e prokurimi publik SEP të APP “2-PROCESVERBAL_ME_ARGUMENTIME”, gjykon së AK ka vendosur kriterë jo proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit.

Konkretisht PC STORE sh.p.k kundërshton kriterin e vendosur tek: Shtojca 8, FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT , pika 2-KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, nenpika 2.3.-KAPACITETI TEKNIK., paragrafi 2.3.2, 2.3.3:

? 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik
Të paktën 1 (nje) Inxhinier Mekatronik
Të paktën 1 (nje) Inxhinier IT/Informatike

? 2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 5 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë: (tre) inxhinier sipas kërkesave në pikën 2.3.2 dhe 2 (dy) shoferë që do të kryejnë transportin e pajisjeve artikujve të printerave.

Dhe përcaktimet e vendosura në Shtojcën 5, FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, si vijon:

? Operatori ekonomik duhet të jetë Distributor Zyrtar për territorin e Republikës së Shqipërisë për softëare që posedon/ ose të jete i i paisur me autorizimin nga distributori zyrtar vendas/rajonar ose ekujvalent për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

Në këtë rast operatori ekonomik duhet të deklarojë adresat, nr. tel, email, emer mbiemer të personave të kontaktit në kompaninë prodhuese për verifikimin e certifikateve.

? *Numri i këtyre pajisjeve mund të shtohet për shkak të kërkesës së lartë të fluksit të punës ose defekteve të riparueshme të pajisjeve që Autoriteti Kontraktor zotëron.

Këto kritere, në përgjithësi përbëjnë shkelje të legjislacionit dhe për këtë kemi paraqitur faktet dhe argumentat e mëposhtme.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

? Pika 1

AK në DST e publikuar ka specifikuar dhe kërkuar si më poshtë :

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Mekatronik

Të paktën 1 (nje) Inxhinier IT/Informatike

Këtë kërkesë e konsiderojmë jo proporcionale dhe sigurisht, një kërkesë që nuk ka lidhje direkte me objektin e prokurimit.

Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimet në RSH, konkretisht ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në nenin 77 përcaktohet se kriteret e vendosura nga Ak duhet të kenë lidhje me objektin e prokurimit, citoj:

Neni 77

Kërkesat për kualifikim

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar qëllimin dhe objektin e prokurimit, i referohemi Shtojcës mbi Termat e Referencës, si vijon:

“Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Objekti i shërbimeve është printimi dhe fotokopjimi për të gjithë Shoqërinë Rajonale Ujësjetelës Kanalizime Durrës me shpërndarje si më poshtë.”

Dhe Formularit të Specifikimeve Teknike, si vijon:

“FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët ose ekuivalent”.

? Në cmimin e dhënë përfshihet Letra A3/A4. Duhet të përfshihen pajisjet (21 pajisje A4 & A3 bardhe zi dhe color), te gjithë tonerat e nevojshëm deri në përfundim të kontratës së mjaftueshme për printime deri në përfundimin e kontratës, drumet dhe cdo pjesë këmbimi tjetër për mirëfunksionimin e pajisjeve.

? Te gjithë tonerat duhet të jenë origjinale të llojit të printerit ose ekuivalent me të dhe të qëndrojnë stok në magazinën e institucionit. Të paktën një toner rezervë për cdo tip pajisje funksionale, duhet të jetë prezent në magazinën e institucionit.

? Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 4 (kater) orëve për difektet e pajisjeve. Në rastin kur pajisja nuk riparohet brenda 4 (kater) orëve, pajisja duhet të zëvendësohet brenda 24 orëve.

? Kohezgjatja e Shërbimit do të jetë për 12 muaj.

? Pajisjet do të vendosen në ambjentet e UK Durrës, UK Kavaje, UK Kruje, UK Shijak, UK Rrogozhinë.

? Pajisjet duhet të funksionojnë 24 orë në ditë

? Pajisjet duhet të funksionojnë si printer, fotokopje dhe skaner për te gjithë përdoruesit e mundshëm duke u lidhur me rrjetin ekzistues të UK Durrës, UK Kavaje, UK Kruje, UK Shijak, UK Rrogozhinë.”

Duke u nisur nga sa më sipër, evidentojmë që objekti i prokurimit nuk ka lidhje me kriterin e vendosur nga AK në DST, kështu duke mosrespektuar përcaktimet ligjore në fuqi.

AK ka kërkuar që nga operatori fitues të disponohen 3 inxhinierë, 1 elektronik, 1 mekatronik dhe 1 informatik/IT, për një procesurë prokurimi e llojit të hapur e thjeshtuar shërbimesh për printimin dhe fotokopjimin e dokumentave të punës normale të institucionit për një periudhë 12 muaj.

Në prima facie, kjo duke si një kërkesë e tepruar, jo proporcionale me objektin e prokurimit.

Për të përcaktuar se çfarë detyrash përmbushin inxhinierët e kësaj kategorie, i drejtohem Listës Kombëtare të Profesioneve, konkretisht VKM Nr. 514 datë 20.9.2017 _Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lkp) të rishikuar, konkretisht për Inxhinier elektronik ka përshkrimin e profesionit si vijon:

Inxhinierë elektronikë” Kodi i profesionit: 2152

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Inxhinierë metalurgjie”, niveli i katërt i kompetencës në LKP.

Inxhinierët elektronike kryejnë studime, dizajnojnë ose drejtojnë funksionimin, mirëmbajtjen dhe riparojnë sistemet elektronike dhe studiojnë e këshillojnë mbi aspektet teknologjike të materialeve, produkteve apo proceseve inxhinierike elektronike. Ata mund të punësohen në organizata private dhe institucione shtetërore.

Funksionet kryesore

Inxhinierët elektronike kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Këshillojnë mbi ose dizajnojnë pajisje elektronike ose komponentë, qarqe, gjysmë-përçues dhe sisteme;
- b) Specifikojnë prodhimin dhe metodat e instalimit, materialet dhe standardet e cilësisë dhe drejtojnë prodhimin ose punën e instalimit të produkteve dhe sistemeve elektronike;
- c) Përcaktojnë standardet dhe procedurat e kontrollit për të siguruar funksionim eficient dhe të sigurtë të sistemeve elektronike, motorëve dhe pajisjeve;
- d) Organizojnë dhe drejtojnë mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve dhe pajisjeve elektronike ekzistuese;
- e) Dizajnojnë qarqe elektronike dhe komponentë për përdorimin e tyre në fusha të tilla si udhëzime për hapësirën ajrore, kontrollin e shtypjes, akustikën, mbi kontrollin e instrumenteve;
- f) Studiojnë dhe këshillojnë mbi sistemet e radarëve, telemetrisë dhe kontrollit në distancë, për mikrovalët dhe pajisje të tjera elektronike;
- g) Dizajnojnë dhe zhvillojnë algoritme mbi përpunimin e sinjalit dhe i zbatojnë ato në zgjedhjen e duhur harduerë dhe softuerë;
- h) Zhvillojnë aparatura dhe procedura për të testuar komponentët elektronikë, qarqet dhe sistemet e tyre;
- i) Bëjnë kërkim-zhvillim për sistemet elektronike, fushat e arkitekturës të kompjuterëve, arkitekturës të sistemeve të përpunimit të informacionit, projektim i sistemeve shifrore, etj.;
- q) Kontrollon dhe menaxhojnë punën e personelit nën varësi;
- r) Sigurojnë që specifikimet dhe dimensionet e përdorura në prodhim janë të sakta;
- n) Kryejnë teste performance;
- o) Regjistrojnë çdo defekt dhe analizojnë shkaqet e tij;
- p) Zbatojnë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;
- j) Rritin aftësitë e tyre profesionale përmes kurseve dhe trajnimeve të ndryshme .

Kërkesat për punësim

a. Arsimi i Lartë, preferohet në degët: Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Informatike, Inxhinieri elektronike etj.;

b. Preferohet njohje të programeve MS Office, UNIX, LINUX, VMS Systems, Oracle, SQL, C, C++, Java etj.;

c. Trajnime profesionale ne këtë sektor, Certificate Cisco (CCNA) për instalime rrjeti është avantazh etj.

Informacion shtesë

Një inxhinier elektronik mund ta nisë punën dhe si ndihmës, teknik për pajisjet elektronike dhe me kryerjen e disa kurseve apo universitetit të punësohen si inxhinier elektronik. Inxhinieri elektronik mund të punësohet në telefoninë celulare mobile; telefoni fikse; krijimi i aplikacioneve ëeb; zhvillimi i softuerëve të ndryshëm; krijimi dhe mirëmbajtja e rrjetave të kompjuterëve etj. (p.sh. në banka, televizione, aeroporte dhe institucione të tjera etj.), inxhinier IT.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

2152.01 Inxhinier elektronik për gjysmëpërçuesit

2152.02 Inxhinier elektronik për informatikën

2152.03 Inxhinier elektronik për instrumente shkencor

2152.04 Inxhinier elektronik për ndërtimin e ordinatorëve

2152.05 Inxhinier për kontroll dhe përdorim instrumentesh

2152.06 Inxhinier kompjuteri/harduer

2152.07 Inxhinier elektronik

2152.08 Inxhinier për impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

2152.09 Inxhinier për impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.

Për inxhinierët mekatronik është përshkrimi si vijon:

“Inxhinierë të tjerë që nuk janë klasifikuar diku tjetër” Kodi i profesionit: 2149

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Inxhinierë të tjerë që nuk janë klasifikuar diku tjetër”, niveli i katërt i kompetencës në LKP.

Në këtë grup hyjnë inxhinierë që nuk janë klasifikuar në dy grupet 214 dhe 215. Këtu përfshihen ata specialistë të inxhinierisë që kryejnë kërkime, këshillojnë dhe zhvillojnë procedura dhe zgjidhje inxhinierike, lidhur me sigurinë në vendin e punës, inxhinieri biomjekësore, optike, për pastrimin e mjediseve industriale, inxhinierë merceologë etj.

Funksionet kryesore

Inxhinierët e tjerë që nuk janë klasifikuar diku tjetër kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Dizajnojnë, zhvillojnë dhe vlerësojnë sisteme dhe produkte biologjike, shëndetësore, si organe artificiale, proteza, sisteme imazhi të rezonancës magnetike, pajisje për kontrollin e funksioneve të trupit etj.;
- b) Dizajnojnë kampionët e instrumenteve optikë, si lente, mikroskopë, teleskopë, lazer, sisteme të disqeve optike dhe të tjera pajisje që përdoren për të shfrytëzuar mundësitë e dritës;
- c) Dizenjojnë impiante apo pajisje që përdoren për pastrimin e ambienteve industriale;
- d) Vlerësojnë dëmet dhe bëjnë llogaritje operacionet e projekteve të tyre inxhinierike;
- e) Studiojnë dhe këshillojnë mbi aspektet inxhinierike të proceseve të veçanta të prodhimit;
- f) Identifikojnë rreziqet e mundshme dhe sugjerojnë procedurat dhe pajisjet e sigurisë;
- g) Marrin masa për të shmangur ndotjen e mjedisit dhe zbatojnë rregullat e sigurisë në punë;
- h) Organizojnë dhe mbikëqyrin gjithë operacionet e punës në projektet e tyre inxhinierike;
- i) Marrin përsipër përgjegjësitë për problemet e hasura gjatë punës dhe japin zgjidhje;
- j) Japin këshilla për maksimizimin e krahut të punës, rekrutimit të punëtorëve të kualifikuar, uljes së kostove të prodhimit;
- k) Rritin aftësitë e tyre profesionale.

Kërkesat për punësim

- a. Arsim i lartë, preferohet në inxhinieri;
- b. Aftësi për të vepruar;

c. Aftësi analitike dhe komunikuese.

Informacion shtesë

Një individ mund ta nisë punën si një teknik inxhinierik. Për këtë nevojitet arsim profesional para universitar. Me kryerjen e arsimit të lartë në Inxhinieri mund të punësohet si Inxhinier që përfshihet në këtë grup. Me kualifikime dhe eksperiencë pune ai mund të marrë detyra drejtuese. Por mund dhe të punojë në institucione shkencore e kërkimore.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

2149.01 Inxhinier këshilltar për organizimin industrial

2149.02 Inxhinier për organizimin shkencor të punës

2149.03 Inxhinier për pastrimin e ambienteve industriale

2149.04 Merceolog i lartë i përgjithshëm

2149.05 Merceolog industrial

2149.06 Merceolog profil turizmi

2149.07 Merceolog ushqimor

2149.08 Inxhinier mekatronik

2149.09 Inxhinier në biomjekësi

2149.10 Inxhinier për pajisje e lëndë shpërthyes

2149.11 Inxhinier për shpëtim detare

2149.12 Inxhinier për studimin e materies

2149.13 Inxhinier i studimeve hapësinore

2149.14 Inxhinier për sigurinë

2149.15 Inspektor investigimi i aksidenteve/incidenteve ajrore në aviacionin civil

Dhe për inxhinierët informatikë është përshkrimi si vijon:

“Zhvillues të softuerit” Kodi i profesionit: 2512

Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Zhvillues të softuerit”, niveli i katërt i kompetencës në LKP.

Zhvilluesi i softuerit analizon, dizajnon, zhvillon dhe mirëmban sistemet dhe programet, që mundësojnë punë sa më efektive të organizatave dhe pajisjeve që ato përdorin, shpesh duke u këshilluar nga një analist i sistemeve apo nga një arkitekt sistemi. Në punën e tij ai zbaton njohuri të shumëllojshme të gjuhëve të programimit dhe sistemeve të manaxhimit të bazave të të dhënave. Ai mund të punësohet në kompani të shërbimeve që ofrojnë zhvillim apo programim softueri, apo të vetëpunësohet.

Funksionet kryesore

Zhvilluesit e softuerit, kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

a) Kryejnë rishikimin e sistemeve aktuale;

b) Paraqesin ide për përmirësimin e sistemit;

c) Bëjnë një përlllogaritje të kohës për realizimin e kërkesave;

d) Bashkëpunojnë ngushtë me inxhinierët për vlerësimin e ndërfaqeve ose faktorëve të tjerë ekzistues midis harduerit dhe softuerit;

e) Përshtatin specifikimet në gjuhë teknike dhe shkruajnë kode të programeve; f) Testojnë

produktet në situata reale të kontrolluara, para se të operojë “live”; g) Bëjnë integrimin e softuerëve ekzistuese;

h) Asistojnë në hartimin e rasteve të testimit;

i) Bëjnë komentet e nevojshme në kod gjatë procesit të zhvillimit, në mënyrë që kodi të jetë sa më i kuptueshëm për referencë të mëvonshme;

j) Rishikojnë rezultatet e testit;

k) Rregullojnë problemet teknike (Bug-et);

- l) Përgatitin skedarët e instalimit;
- m) Përmirësojnë softuerët ekzistuese;
- n) Konsultohen me kolegë dhe të tjerë për probleme në lidhje me performancën dhe mirëmbajtjen e sistemeve softuer;
- o) Përditësojnë njohuritë mbi zhvillimet e reja teknologjike teknikat e programimit dhe pajisjet kompjuterike;
- p) Bashkëpunojnë me analistët e sistemeve për të kuptuar kërkesat e klientit dhe për t'i zbatuar ato në kod;
- q) Kryejnë versionimin e kodit të aplikacioneve sipas procedurave;
- r) Bëjnë dokumentim të zgjidhjes teknike;
- s) Kryejnë mirëmbajtjen e sistemit;
- t) Zbatojnë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit;
- u) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim

- a. Zakonisht kërkohet të ketë diplomë universitare në informatikë, shkenca kompjuterike ose inxhinieri elektronike;
- b. Nivel i larte aftësish organizative dhe analitike;
- c. Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht.
- d. Njohuri të mira mbi algoritmet dhe njohuri bazike në gjuhën e programimit për të cilën kërkohet;
- e. Aftësi të mira në kuptimin e kodeve të shkruar

Informacion shtesë

- a. Një individ mund të hyjë në profesion si ndihmës. Me eksperiencë dhe me kualifikim shtesë mund të kalojë në nivelin punëtor i kualifikuar. Më pas nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale dhe teknike apo trajnimit nëpërmjet punës, një zhvillues softueri mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës në nivel Arkitekti. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit.
- b. Për të zhvilluar aktivitet privat (vetëpunësim) në këtë fushë duhet regjistrim për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.
- c. Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si:
Informatikan, Inxhinier informatikan, Konceptues në sisteme informatike, Programues kompjuteri etj.

Shembuj të punësimeve të përfshira në këtë profesion që klasifikohen në Listën Kombëtare të Profesioneve:

- 2512.01 Informatikan
- 2512.02 Inxhinier informatikan
- 2512.03 Konceptues në sisteme informatike
- 2512.04 Analisti programues
- 2512.05 Projektuesi softuer
- 2512.06 Zhvillues softuer
- 2512.07 Inxhinier softuer
- 2512.08 Programues kompjuteri

Pra duke u bazuar nga përshkrimet e mësipërme që gjenden në Listën Kombëtare të Profesioneve, inxhinierët kanë fushë kompetence shumë më të gjerë dhe ekspertiza e tyre është e nevojshme në rast projektimi, dizenjimi apo drejtimi të prodhimit të pajisjeve elektronike, mekanike apo sistemeve informatike.

Ndërkohë referuar Termave të Referencës së procedurës së prokurimit, kërkohet vetëm marrja me qira e disa pajisjeve të prinimit, instalimi i tyre dhe ato pajisje do të printojnë dhe fotokopjojnë. Këtë detyrë mund ta kryejë cdo teknik elektronik i pajisur me certifikatë nga prodhuesi i pajisjeve të printimit të markës së caktuar ose ekuivalent i asaj marke.

AK nuk mund të vendosë kritere tenderi të panevojshme për realizimin e kontratës, kritere të cilat as nuk mund ti argumentojë ligjërisht dhe teknikisht me nevojën për realizimin e kontratës, kështu duke shkelur parimin e proporcionalitetit në vendosjen e kritereve.

Për të vërtetuar që një kriter është apo jo në respekt të parimit të proporcionalitetit, aplikojmë “testin e proporcionalitetit”.

“Tradicionalisht ky parim konsiderohet se përbëhet nga 3 elementë.

Gjykata duhet të vlerësojë nëse masa e ndërmarrë për të mbrojtur një interes të ligjshëm është:

b) e përshtatshme për arritjen e objektivit të kërkuar. Vlerësimi i përshtatshmërisë duhet të bazohet në standarde objektive. Kjo do të thotë se veprimet e shtetit nuk duhet të bazohen në vlerësime apo në

argumente veçanërisht të diskutueshme;

c) e domosdoshme, në kuptimin që ligjvënësi, ose administrata nuk kishte asnjë mundësi tjetër në dispozicion që të jetë më pak kufizuese ndaj lirisë së individit. Duhet që të përdoret mjete më pak drastik i

mundshëm. Kjo do të thotë se masa e ndërmarrë duhet të jetë e nevojshme për të përmbushur një qëllim të caktuar dhe se ky i fundit nuk mund të arrihet me anë të masave të tjera të cilat janë të efektshme dhe njëkohësisht më pak të dëmshme për interesat e individëve;

ç) proporcionale stricto sensu (proporcionaliteti në kuptimin e ngushtë). Në bazë të këtij elementi të tretë, kontrolli është i orientuar drejt peshimit të interesave të përfshira në konflikt. Duhet të merret në konsideratë nëse masa është në disproporcion me kufizimet e vendosura. Kjo do të thotë se edhe pse masa është e përshtatshme dhe e domosdoshme në krahasim me masat e tjera të mundshme, duhet të zëvendësohet me një tjetër masë më pak të përshtatshme, për shkak të një ndikimi të konsiderueshëm dhe të pafavorshëm mbi të drejtën themelore apo interesa të tjera. Pra, përparësitë për të cilat ajo është e preferuar mbi masa të tjera, nuk janë në përpjestim me dëmin që ato shkaktojnë. Kjo do të thotë se masa në fjalë imponon një barrë të tepërt për individin ose subjektin të cilit i janë kufizuar të drejtat.”(Studime Juridike 1, FDUT, Adea Pirdeni, Erind Merkuri).

Pra duke iu referuar kriterit të vendosur dhe duke aplikuar testin e proporcionalitetit, nëse kriteri është:

1. I përshtatshëm për arritjen e objektivit pra të zbatimit të kontratës në mënyrë sa më optimale
2. I domosdoshëm, pra AK nuk kishte asnjë mundësi tjetër përveqse të vendoste këtë kriter
3. Dhe kriteri është proporcional, në kuptim të përshtatshmërisë së kriterit me situatën reale, pra duke marrë parasysh kriterin e vendosur dhe aftësinë teknike e zbatuese të operatorëve ekonomike në treg për të garantuar konkurrencë të lirë në procedurat e prokurimit publik.

Le ti marrim me radhë këto 3 kushte për të përcaktuar nëse kriteri është apo jo proporcional.

1. Në lidhje me përshtatshmërinë e 3 inxhinierëve për arritjen e qëllimit, që është realizimi i kontratës.

Inxhinierët mekatronikë, elektronikë dhe informatikë/IT, shërbejnë për të dizenuar projektuar, drejtuar prodhimin dhe mbikqyrjen e prodhimit të pajisjeve dhe sisteme elektronike, mekanike informatike, të vecuara ose të kombinuara së bashku, dhe jo për të lidhur disa printera me kompjuterat e institucionit, për ti furnizuar me letër dhe tonera dhe për të nxjerrë një raport se sa printime janë kryer në një periudhë të caktuar.

Pra nuk janë të përshtatshme për të arritur qëllimin e procedurës së prokurimit.

2. Në lidhje me domosdoshmërinë e pasjes së 3 inxhinierëve.

Pasja e 3 inxhinierëve nuk është e domosdoshme, në kuptimin e domosdoshmërisë që AK nuk ka asnjë mundësi tjetër për të vendosur dëshmi të tjera që i japin garanci AK që procedura e prokurimit do të realizohet në mënyrë të kënaqshme.

Për të realizuar objektin e kontratës, mjaftojnë të paraqiten disa teknikë servisi kompjuterik me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik për të montuar dhe vënë në punë pajisjet objekt prokurimi.

Pra nuk janë të domosdoshëm paraqitja e 3 inxhinierëve për të realizuar këtë procedurë prokurimi.

3. Në lidhje me proporcionalitetin stricto sensu, në kuptimin e kontrollit të orientuar drejt peshimit të interesave.

Kur AK vendos një kriter, duhet të marrë parasysh që kriteret janë jo proporcionale nëse më shumë sesa arrihet qëllimi i procedurës së prokurimit, këto kritere kufizojnë konkurrencën në atë masë, sa paraqitet vetëm një ofertues i vetëm në tender.

Shoqëria jonë, PC STORE, ka një eksperiencë të gjatë në këtë fushë, në shërbimin e printimit të menaxhuar, dhënie me qira të pajisjeve dhe shitjen e tyre, pra e njohim mirë këtë fushë dhe nga eksperiencia jonë deklarojmë që një numër të tillë inxhinierësh e disponon në treg një numër shumë i kufizuar operatorësh dhe kjo e kombinuar me brandet e pajisjeve, krijon saktësisht premisat që kjo procedurë prokurimi të jetë e paracaktuar se kush do të jetë fituesi.

Në hartimin e DST dhe konkretisht kërkesave për kualifikim, AK duhet të shmangë vendosjen e kërkesave që nuk kanë lidhje me kontratën dhe shërbejnë vetëm për të kufizuar konkurrencën mes OE.

Pra kriteri për disponimin e 3 inxhinierëve i shërben AK vetëm për të kufizuar konkurrencën në mënyrë që këtë procedurë prokurimi ta fitojë një operator ekonomik i caktuar.

Autoritetet Kontraktore duhet të marrin parasysh edhe udhëzimet/rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, direktiva të cilat instruktojnë në mënyrë të saktë dhe shteruese se si duhet vepruar në praktikën e prokurimit publik.

Konkretisht, në Rekomandimin Nr.7998 të datës 24.12.2021, Agjencia e Prokurimit Publik e vë edhe një herë theksin të rëndësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit në harmoni me procedurën e tenderit, citoj:

5. Sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteteve kontraktore që kërkesat për kualifikim duhet në çdo rast të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës që prokurohet.

Nga asistimet e deritanishme, APP ka konstatuar se AK përcaktojnë te kriteret e vecanta të kualifikimit kërkesa që nuk kanë lidhje me objektin e kontratës, ose që tejkalojnë nevojat për zbatimin me sukses të kontratës.

Në rast konkret në lidhje me këtë problematikë, lidhet me kontratat e punëve, ku AK përcaktojnë shpesh kërkesa për kategori në licencën profesionale për zbatimin e punimeve të ndërtimit, të cilat nuk përputhen me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që janë të përfshira në preventivin e punimeve, apo kërkesa që kategoritë e kërkuara të kenë nivele klasifikimi që e tejkalojnë vlerën e punimeve sipas kategorisë përkatëse, apo edhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Pra Agjencia e Prokurimit Publik (APP) në rekomandimin e sipërcituar, e vë theksin për të disatën herë tek proporcionaliteti i kriterëve me objektin e procedurës së prokurimit, duke iu bërë me dije AK që cënimi i këtij raporti proporcional është cënim në vetvete i gjithë procedurës dhe legjislacionit të prokurimit publik

Vendosja e kriterëve që orientojnë procedurën e prokurimit drejt disa operatorëve të caktuar, është kufizim i konkurrencës dhe shkelje e barazisë në tendera dhe ankande publike.

Duke qenë se kushtet e “testit të proporcionalitetit” janë kumulative, pra duhet të përmbushen njëherësh, dalim në përfundimin që kriteri nuk i përmbush të gjitha kushtet që të konsiderohet proporcional.

Një kriter jo proporcional, është shkelje e LPP, neni 77, Kërkesat për kualifikim, citoj:

Neni 77

Kërkesat për kualifikim

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Dhe duke qenë se një kriter është proporcional, AK duhet ta modifikojë.

Nënpika 2: Gjithashtu për sa i përket kësaj pikë, në hartimin e DST Ak ka demonstruar gabime thelbësore, konkretisht si vijon:

Në DST, te Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.2, është vendosur kriteri, si vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Mekatronik

Të paktën 1 (nje) Inxhinier IT/Informatike

Ndërsa në procesverbalin e argumentimit është përcaktuar:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- a) Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik për të instaluar dhe konfiguruar pajisje multifunksionale (printerat fotokopje skaner) dhe pershtatja me rrjetin ekzistues të AK.
- b) Të paktën 1 (nje) Inxhinier Mekatronik për të instaluar dhe konfiguruar pajisje multifunksionale, evidentuar, interpretuar problematikat e mundshme gjate përdorimit të pajisjes dhe zgjidhja e problemit.
- c) Të paktën 1 (nje) Inxhinier IT/Informatike për të instaluar dhe konfiguruar pajisje multifunksionale me softëare perkates. Te lexoje dhe interpretoje softëare-in, pjesë e prokurimit.

Nisur nga evidentimi i sipërcituar, kemi të bëjme më një mungesë koherence në hartimin dhe

vendosjen e kriterëve pasi në procesverbal argumentimi janë zgjeruar kriteret në fjalë, ndërkohë që nuk e lejon ligji.

Për krahasim : Kriteri konkret në DST kërkon “Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik” dhe në procesverbal argumentimi është “Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik për të instaluar dhe konfiguruar pajisje multifunksionale (printer fotokopje skaner) dhe pershtatja me rrjetin ekzistues të AK” , kështu duke shkaktuar konfuzion për operatorët në hartimin dhe paartqitjen e ofertave.

AK duhet të përcaktojë në dokumenta tenderi se çfarë kërkon saktësisht dhe formulari i argumentimit shërben vetëm për ta argumentuar teknikisht dhe ligjërisht një kriter dhe në asnjë rast nuk mund të zgjerohet kriteri apo të ketë një kriter tjetër ndryshe nga ato të përcaktuar në DST.

Nëse AK kërkon që të përcaktojë punonjës që duhet të shërbejnë për të instaluar dhe vënë në punë pajisjet, duhet të kërkojë në DST punonjësin dhe certifikimin konkret e nëse përmendet markë duhet të aplikojë termin “Ekuivalent” pas çdo marke.

Për sa më sipër, për këtë pikë përfundimisht, kërkojmë:

? Kërkesa 1:

Kriteri: “2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik
Të paktën 1 (nje) Inxhinier Mekatronik
Të paktën 1 (nje) Inxhinier IT/Informatike”

të modifikohet dhe të bëhet:

“2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik
Të paktën 2 (dy) specialistë/teknikë për instalimin e pajisjeve të printimit, të certifikuar përshtatshëmrisht nga Prodhuesi i pajisjeve ose ekuivalent.”

? Nënkërkesa 1:

Të modifikohet procesverbali i argumentimit dhe të njehësohen kriteret e reja me ato në procesverbal argumentimi.

? Pika 2

Në Formularin e Specifikimeve Teknike Shtojca 5, , AK ka kërkuar, citoj:

“Operatori ekonomik duhet të jetë Distributor Zyrtar për territorin e Republikës së Shqipërisë për softëare që posedon/ ose të jete i i paisur me autorizimin nga distributori zyrtar vendas/rajonal ose ekuivalent për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.”

AK sërish ka demonstruar paqartësi në hartimin e DST të kësaj procedure tenderi.

Përcaktimin e sipërcituar mbi për: “Operatori ekonomik duhet të jetë Distributor Zyrtar për territorin e Republikës së Shqipërisë për softëra që posedon/ ose të jete i i paisur me autorizimin nga distributori zyrtar vendas/rajonale ose ekuivalent për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.” e ka vendosur jo tek kriteret e vecanta të kualifikimit sic duhet të vendoset sipas formatit të DST të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, por e ka vendosur tek specifikimet teknike. Në fakt, kjo shkakton konfuzion tek operatorët ekonomikë në hartimin e ofertës dhe gjithashtu i hap rrugë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të bëjë vlerësime arbitrare në këtë procedurë tenderi, duke shkelur haptas përcaktimet ligjore mbi barazinë në tendera publike.

AK nuk ka argumentuar vendosjen e këtij përcaktimi në Formularin e Specifikimeve Teknike edhe pse legjislacioni e kërkon një gjë të tillë.

Konkretisht, referuar VKM Nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) Rregullat e Prokurimit Publik, neni 2 “Dokumentimi i procesit”, ndër të tjera, përcaktohet se: Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;”

Ndërkohë AK jo vetëm që e ka keqvendosur kriterin duke krijuar konfuzion në përcaktimin e kërkesave që duhet të plotësojë një OE, por nuk e ka argumentuar fare vendosjen e këtij kriteri, duke i hapur rrugë çdo vlerësimi arbitrar të ofertave në këtë procedurë tenderi.

Gjithashtu po në Shtojcën 5 Formulari i Specifikimeve Teknike, AK ka përcaktuar se:

“*Numri i këtyre pajisjeve mund të shtohet për shkak të kërkesës së lartë të fluksit të punës ose defekteve të riparueshme të pajisjeve që Autoriteti Kontraktor zotëron.”

duke mospërcaktuar se çfarë do të thotë ‘fluks i lartë i punës’ në terma numerikë dhe të matshëm dhe çfarë kuptohet me “defekteve të riparueshme të pajisjeve që Autoriteti Kontraktor zotëron”.

Autoritetet Kontraktore janë organe të administratës publike, ofrojnë shërbime publike përdorin resurse publike, prandaj duhet me patjetër ti referohen parimit të sigurisë juridike në procesin e tyre normal të punës.

Parimi i sigurisë juridike nënkupton qëndrueshmërinë në vendimarrje dhe veprimtari ku subjektet e së drejtës ndërtojnë pritshmëri të qendrueshme nga një procedurë administrative.

Në këtë kuptim, togëfjalëshi “fluks i lartë i punës” në këtë procedurë prokurimi duhet të nënkuptojë kapacitete operationale dhe teknologjike të shtuara për OE fitues të kësaj procedure, të cilat duhet të parashikohen që në hartimin e ofertës.

AK duhet të përcaktojë saktë se çfarë detyrimesh ka një OE i cili do të fitojë këtë kontratë administrative.

Gjithashtu edhe përcaktimi “defekteve të riparueshme të pajisjeve që Autoriteti Kontraktor zotëron” përbën shkelje në kuptim të qartësisë në hartimin e dokumentave të tenderit.

Referuar formularit të termave të referencës, objekti i prokurimit është: “Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Objekti i shërbimeve është printimi dhe fotokopjimi për të gjithë Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës me shpërndarje si më poshtë.” pra është “shërbim printimi i menaxhuar” jo shërbim i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve që Autoriteti Kontraktor zotëron”. Në këtë kuptim, AK duhet të shmangë kërkesat që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit apo

kërkesat e paqarta.

Edhe për sa i përket këtij përcaktimi, AK nuk e ka argumentuar në procesverbalin e argumentimit, duke cënuar edhe njëherë ligjshmërinë e këtij kriteri, përkundër disa udhëzimeve/rekomandimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në lidhje më këtë pikë kërkojmë:

? Kërkesë 2

Të hiqen përcaktimet e mëposhtme:

“Operatori ekonomik duhet të jetë Distributor Zyrtar për territorin e Republikës së Shqipërisë për softëare që posedon/ ose të jete i i paisur me autorizimin nga distributori zyrtar vendas/rajonal ose ekujvalent për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.”

“*Numri i këtyre pajisjeve mund të shtohet për shkak të kërkesës së lartë të fluksit të punës ose defekteve të riparueshme të pajisjeve që Autoriteti Kontraktor zotëron.”

Pika 3.

Në lidhje me specifikimet teknike

Tek DST, shtojta 5 është specifikuar:

* 10 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A3

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

“Funksioni”: Fotokopje/printer/skaner me ngjyra

Shpejtësia “Kopje/Print per A4 =45 ppm

Cikli mujor I punës 40,000 Flete

Nderkohe tek Shtojta 6, është përcaktuar se:

4. Shërbim printimi A3 me ngjyra 50 000

Kerkese 3

Duke qene se kemi nje disnivel mbi kerkesen e pajisjeve 10 COPE dhe Shërbim printimi A3 me ngjyra 50,000 faqe ne vit, qe me nje llogaritje i bie qe cdo pajisje te kryje sherbim printimi me volum 5,000 flete ne vit per pajisje ose ne muaj 417 flete per pajisje, kerkojme modifikimin e specifikimit :

Cikli mujor I punës 40,000 Flete

Te modifikohet ne :

Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle” 10,000 Flete

Kerkesa 4

Duke qene se eshte kerkuar shpejtësia ne formatin A4 si dhe referuar dhe shpjegimeve te kerkeses 1, meqenese volumi i printimeve eshte volum 5,000 flete ne vit per pajisje ose ne muaj 417 fleteper pajisje, kerkojme specifikimin nga :

Shpejtësia “Kopje/Print per A4 =45 ppm

Kerkojme modifikimin ne :

Shpejtësia “Kopje/Print per A3 =10 ppm

Pika 4

Tek DST, shtojta 5 është specifikuar:

5 cope Fotokopje/Printer/Skaner (Bardh/Zi) A4
“Funksioni”: Fotokopje/printer/skaner me ngjyra
Shpejtësia “Kopje/Print per A4 =55 ppm
Cikli mujor I punes 350,000 Flete

Nderkohe tek Shtojta 6 , eshte percaktuar se:

1. Shërbim printimi A4 bardh/zi 2 500 000

Kerkese 5

Duke qene se kemi nje disnivel mbi kerkesen e pajisjeve 5 COPE dhe Shërbim printimi A3 me ngjyra 350,000 faqe ne vit , qe me nje llogaritje i bie qe cdo pajisje te kryje sherbim printimi me volum 70,000 flete ne vit per pajisje ose ne muaj 5,834 flete per pajisje , kerkojme modifikimin e specifikimeve :

Cikli mujor I punes 350,000 Flete

Te modifikohet dhe te vendoset:

Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle” 20, 000 Flete

Kerkesa 6

Duke qene se kemi nje disnivel mbi kerkesen e pajisjeve 5 COPE dhe Shërbim printimi A3 me ngjyra 350,000 faqe ne vit , qe me nje llogaritje i bie qe cdo pajisje te kryje sherbim printimi me volum 70,000 flete ne vit per pajisje ose ne muaj 5,834 flete per pajisje , kerkojme modifikimin e specifikimeve dhe te vendosen:

Shpejtësia “Kopje/Print per A4 =55 ppm

Kerkojme modifikimin ne :

Shpejtësia “Kopje/Print per A3 =20 ppm

Pika 5

Tek DST,shtojta 5 eshte specifikuar:

* 6 Fotokopje/Printer/SkanerA3 Bardh e zi

“Funksioni”: Fotokopje/printer/skaner

Shpejtësia “Kopje/Print per A4 B&W”: =55 ppm

Nderkohe tek Shtojta 6 , eshte percaktuar se:

Shërbim printimi A3 bardh/zi 150 000

Kerkesa 6

Duke qene se kemi nje disnivel mbi kerkesen e pajisjeve 6 COPE dhe Shërbim printimi A3 me ngjyra 150,000 faqe ne vit , qe me nje llogaritje i bie qe cdo pajisje te kryje sherbim printimi me volum 25,000 flete ne vit per pajisje ose ne muaj 2,084 flete per pajisje , kerkojme modifikimin e specifikimeve dhe te vendosen:

Shpejtësia “Kopje/Print per A4 =55 ppm

Kerkojme modifikimin ne :

Shpejtësia “Kopje/Print per A3 =10 ppm

Në praktikat e prokurimit publik, duhet të shmangen kriteret që krijojnë kufizime në konkurrencë dhe duhet një studim tregu i mirëfilltë se çfarë kapacitetesh kanë operatorët në treg në raport edhe me nevojat e AK.

AK duhet të ketë parasysh në cdo rast se parimet e LPP, si pjesëmarrja e gjerë, konkurrenca mes operatorëve ekonomikë dhe integriteti i procedurës së prokurimit, janë postulate të padiskutueshme të integritetit dhe besimit në procedurat e prokurimit publik.

Dispozitat më poshtë, e parashikojnë në mënyrë eksplicite se çfarë duhet të ketë parasysh AK:

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21

Autoriteti ose enti kontraktor

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 87

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose

entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

Dhe neni 45 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK, citoj;

Neni 45

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

Po ashtu vendosja e këtyre kriterëve përbën një shkelje të Kodit të Procedurave Administrative në RSH, neni 13, neni 14, citoj:

Neni 13

Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë

Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Neni 14

Parimi i objektivitetit

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.

Autoritet Kontraktore duhet të marrin parasysh që procedurat e tenderit duhet të jenë të formuluar në një formë që të nxisin konkurrencën e lirë mes operatorëve, sic përcakton edhe vendimi i GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike.

Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Duke iu referuar një ndër qëllimeve kryesore të ligjit ku parashikohet se eficaenca, efikasiteti dhe mirëpërdorimi i fondeve publike, konkretisht neni 2, citoj:

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë eficaencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik.

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

janë postulate të padiskutueshme në referim të këtij ligji, Autoritetet Kontraktore duhet të mbajnë parasysh që të prokurojnë mallra shërbime punë në mënyrë sa më efikase duke përfituar një cmim sa më të ulët.

Dhe cmimet e ulta dhe konkruuese e bën një procedurë ku ofron shance të barabarta për të gjithë ofertuesit e mundshëm, pra duke mos aplikuar kriterë përjashtuese, kriterë që nuk kanë lidhje me

objektin e procedurës së prokurimit dhe/ose kritere që orientohen drejt një ofertuesi të caktuar apo një grupi ofertuesish, që automatikisht kufizon konkurrencën, rrjedhimisht duke bërë që të ofrohen cmime më të larta.

Kjo sjellje bie ndesh edhe me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, konkretisht Ligjin Nr.9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku parashikohet se institucionet duhet të kenë parasysh përdorimin efiçent të fondeve publike, konkretisht neni 3 dhe neni 4 i ligjit, citoj:

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Buxhet” është tërësia e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore dhe të fondeve speciale, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, më poshtë “Kuvendi” ose me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 4

Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor

Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë:

ç) përdorimi ekonomik, efiçent dhe efektiv i burimeve publike;

ku përcaktimi në ligj është shterues që është detyrë kryesore e intitucioneve mirëmenaxhimi i fondeve publike. Në këtë kuptim, AK, duke kufizuar konkurrencën, automatikisht keqmenaxhon edhe fondet publike.

Për të konkluduar PC STORE shpk në vazhdim të arsyetimit të paraqitur më lart, i gjykon më se të drejta e të ligjshme pretendimet e paraqitura.

Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkojmë:

1. Pranimin e ankesës sonë.
2. Kriteri: “2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Mekatronik

Të paktën 1 (nje) Inxhinier IT/Informatike”

të modifikohet dhe të bëhet:

“2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Të paktën 2 (dy) specialistë/teknikë për instalimin e pajisjeve të printimit, të certifikuar

përshtatshmërisht nga Prodhuesi i pajisjeve ose ekuivalent.”

Të modifikohet procesverbali i argumentimit dhe të njehësohen kriteret e reja me ato në procesverbal argumentimi.

3. Të hiqen përcaktimet e mëposhtme:

“Operatori ekonomik duhet të jetë Distributor Zyrtar për territorin e Republikës së Shqipërisë për softëare që posedon/ ose të jete i i paisur me autorizimin nga distributori zyrtar vendas/rajonal ose ekuivalent për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.”

“*Numri i këtyre pajisjeve mund të shtohet për shkak të kërkesës së lartë të fluksit të punës ose defekteve të riparueshme të pajisjeve që Autoriteti Kontraktor zotëron.”

4. Të modifikohen specifikimet teknike të tenderit sipas kërkesave tona.

5. Modifikimin e dokumentave të tenderit.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

Informacione që nuk gjenden në regjistra publike.

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit: 042221076

E-mail: info@pcstore.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar Vitator Mehmeti